



## Rifillojnë veprimtaria dhe shërbimet gjyqësore!

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka marrë Vendimin nr. 143, datë 22.04.2020 *“Për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore”*, për rifillimin e plotë të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e Republikës së Shqipërisë, duke nisur nga data 27.04.2020.

Veprimtaria dhe shërbimet gjyqësore do të kryhen në përputhje dhe në respektim të masave për kufizimin e përhapjes së COVID – 19 sipas Aktit Normativ nr.9, datë 25.03.2020, *“Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”* (**Akti Normativ nr. 9**). Këshillat dhe kryetarët në detyrë të gjykatave ngarkohen për të marrë masat e duhura.

Njoftimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk jep detaje të mëtejshme në lidhje me masat që do të merren gjatë funksionimit të gjykatave në zbatim të Aktit Normativ nr. 9.

Rifillimi i veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore vjen në kontekstin e lehtësimit të masave kundër COVID-19 në të gjithë vendin, pasi ishin pezulluar me përjashtim të disa rasteve të veçanta, prej datës 10.03.2020 nëpërmjet vendimeve të njëpasnjëshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor.



## The judicial activity and services recommence!

The Supreme Judicial Council has resolved with Decision no. 143, date 22.04.2020 "*On the resumption of judicial activity and services*", the complete resumption of judicial activity and services, starting from 27.04.2020.

Said activity and services will be conducted in accordance and compliance with the measures taken against the spreading of COVID-19 as provided from the Normative Act of the Council of Ministers no.9, dated 25.03.2020 "*On special measures in the field of judicial activity during the infection period caused by Covid-19*" (**Normative Act no. 9**). The chairman and the council of the courts are responsible for these measures.

The notice of the Supreme Judicial Council does not provide further details on the measures which will be applied by courts in light of the Normative Act no. 9.

The resumption of the judicial activity and services comes in the context of the easing of measures in the whole country, after having been suspended save for exceptional cases, from 10.03.2020 through successive decisions of the High Judicial Council.